


KONTRATE KONÇESIONI
E FORMES "ROT" (REHABILITIM - OPERIM - TRANSFERIM)
PER REHABILITIMIN E HIDROCENTRALIT "DOMAJ", HAS

REPUBLIKA E SHQIPERISE
ZYRA E NOTERISE TIRANE
NR. 2852 Rep.
NR. 381 Kol.



KONTRATE KONÇESIONI
E FORMES "ROT" (REHABILITIM - OPERIM - TRANSFERIM)
PER REHABILITIMIN E HIDROCENTRALIT "DOMAJ", HAS

Ne Tirane, me date 10 Shtator 2009 (dy mije e nente), para meje notere Bashkimi B. Mela, e regjistruar ne Dhomen e Noterise Tirane, me adrese R. Durrës P.118/11 u paraqiten palet kontraktuese si me poshte:

Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes, percaktuar si "AUTORITET KONTRAKTUES" me Vendimin e Keshillit te Ministrave nr. 1357, date 10.10.2008 "Per percaktimin e autoritetit kontraktues per dhenien me koncesion te hidrocentralit "DOMAJ", dhe miratimin e bonusit, ne proceduren perzgjedhese konkurruese, qe i jepet shoqerise", qe me poshte do te quhet i tille, perfaqesuar nga Titullari, z. Genc RULLI, i datelindjes _____, madhor dhe me zotësi juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u sigurova nga Pasaporta nr. _____

DHE

Bashkimi i përkohshëm i shoqërive "Thaci" Shpk dhe "Lala" Shpk, që në vijim do të quhet "KONCESIONARI", i formuar sipas marrëveshjes nr.238 Kol, nr.51/1 Rep, datë15/01/2009 me këto te dhena:

Shoqëria "Thaci" Shpk rregjistruar si person juridik me Vendimin nr.36361, dt.19/09/2006, të Gjykates së Rrethit Tirane,

Shoqëria "Lala" Shpk, rregjistruar si person juridik me Vendimin nr.18847, dt.23/02/1998, të Gjykatës së Rrethit Tiranë.

Shoqëria "Thaci" shpk është percaktuar si shoqëri kryesuese dhe përfaqësohet nga administratori Z.Shkelqim Thaçi, i biri _____ madhor dhe me zotësi juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u sigurova nga Pasaporta nr. Z _____

Hyrje

Duke patur parasysh qe Qeveria e Shqiperise:

1. I ka dhene nje rol prioritar prodhimit, transmetimit dhe shperndarjes se energjise elektrike nepermjet ndertimit te hidrocentraleve te rinj, ose rehabilitimit te hidrocentraleve ekzistuese me ane te procedurave te koncesionit, per permiresimin e treguesve teknike dhe ekonomike te rrietit elektrik kombetar;

2. Konsideron ndertimin e hidrocentraleve si nje element te rendesishem te politikës se zhvillimit te sektorit te energjise;
3. Vlereson formen "ROT" te konçesionit, si nje forme koncesioni qe ben te mundur stimulimin e investitoreve private per ndertimin e hidrocentraleve te rinj me anen e kapitalit privat;
4. Eshte e angazhuar per krijimin dhe zhvillimin e tregut te brendshem te energjise elektrike brenda vendit;
5. Mirepret investoret vendas ose te huaj ne ndertimin e kapaciteteve te reja prodhuese te energjise elektrike;

Konçesionari

1. Eshte i interesuar te investoje ne ndertimin e hidrocentralit "DOMAJ", ne fshatin Domaj, rrethi Has, me qellimin rritjen e prodhimit te energjise elektrike dhe rritjen e sigurise te furnizimit me energji elektrike te zones;
2. Bashkimi i shoqerive "Thaci" Sh.p.k. dhe "Lala" Shpk zoteron kapacitetet e nevojshme tekniko-financiare, per te realizuar projektin e miratuar sipas objektit te kesaj marreveshje;
3. Ka kryer studimin tekniko-ekonomik dhe mjedisor per rehabilitimin dhe shfrytezimin e hidrocentralit Domaj, objekt i ketij konçesionit;
4. Zoteron aftesite drejtuese, financiare dhe teknike te kerkuara si dhe aftesite per te plotesuar kete iniciative ne perputhje me standartet nderkombetare.

Neni 1 Perkufizime

Kudo qe ne kete Marreveshje perdoren termat e meposhteme, ato do te kene kuptimet perkatese si me poshte si vijon :

- 1.1 **Marreveshja e Konçesionit :** Kjo marreveshje dhe anekset 1 dhe 2 bashkelidhur.
- 1.2 **Autoriteti Kontraktues:** Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes.
- 1.3 **Konçesionari:** Bashkimi i perkohshem i shoqerive "Thaci" Sh.p.k, dhe "Lala" Shpk
- 1.4 **Hidrocentral:** Teresia e objekteve qe sherbejne per prodhimin e energjise elektrike, ku perfshihen vepra e marrjes, kanali i devijimit, bazeni i presionit, tubacioni qe dergon ujin ne turbina, ndertesat e centralit se bashku me makinerite dhe pajisjet e intaluar ne te, qe ne rastin konkret eshte Hidrocentrali "DOMAJ", fshtati Domaj, rrethi Has, me fuqi te instaluar 200 kW dhe prodhim te energjise elektrike rreth 1,000,000 kWh, se bashku me te gjitha objektet qe permenden me siper.
- 1.5 **Kontratat:** Te gjitha kontratat e nenshkruara nga Konçesionari me sipermarresit per realizimin e punimeve;
- 1.6 **Licencë** është akti administrativ, që lëshohet nga autoriteti përkatës publik për të ushtruar një veprimtari, bazuar në kritere objektive të kualifikimit.
- 1.7 **Tarifa koncesionare:** Sasia e energjise elektrike qe i ofrohet pa pagese shtetit.

Neni 2 Objekti i Konçesionit

Objekti i kesaj kontrate konçesioni eshte :

Rehabilitimi, operimi dhe transferimi i hidrocentralit DOMAJ tek Autoriteti Kontraktues, konform termave dhe kushteve te kesaj kontrate.

Neni 3 Karakteristikat e hidrocentralit

3.1. **Hidrocentrali "Domaj"**, do të ndërtohet në Fshatin Domaj, Has, me këto karakteristika:

- **Hidrocentrali "Domaj"**

- | | |
|---|---------------|
| ▪ Fuqia e Instaluar | 200 kW |
| ▪ Prodhimi vjetor i energjisë elektrike | 1.000.000 kWh |

Neni 4 Periudha e Konçesionit

Autoriteti Kontraktues i jep koncesionarit me koncesion rehabilitimin e hidrocentralit "DOMAJ", per nje periudhe 35 vjeçare, sipas shkronjes "b" te nenit 27 te ligjit nr. 9663, date 18.06.2006 "Per koncesionet". Kjo periudhe do te filloje nga hyrja ne fuqi e kesaj Kontrate.

Rastet e zgjatjes së Periudhës së Koncesionit:

Palët bien dakord se për shkaqe që ndikojnë drejtpërdrejt në Projekt (jo të shkaktuara nga Koncesionari) ku përfshihet vetëm Forca Madhore periudha e koncesionit do të zgjatet, në përputhje me kohën e duhur që projekti të konsiderohet si rentabël dhe financiarisht i përshtatshëm në përputhje me analizat financiare të "Vlerës për Para", "IRR" apo çdo lloj analize tjetër të përshtatshme për vlerësime të tilla.

Palët bien dakord se Periudha e Koncesionit do të zgjatet në rastin e një Ngjarjeje të Forcës Madhore, për një periudhë kohe të barabartë me kohën që ka zgjatur Ngjarja dhe kohën e arsyeshme që nevojitet për riparimin e dëmeve të shkaktuara, me kusht që vetë Ngjarja të ketë zgjatur një periudhë kohe që e kalon 1 (një) muaj.

Neni 5 Te drejtat dhe detyrimet e Autoritetit Kontraktues

Autoriteti Kontraktues merr persiper detyrimet e meposhtme:

5.1. Të sigurojë vazhdimësinë e kesaj kontrate pavarësisht ndryshimeve të objektiveve të Sektorit Elektroenergjetik Shqiptar.

- 5.2. Autoriteti Kontraktues me kërkesë të Koncesionarit merr përsipër të bëjë të gjitha përpjekjet për të ndihmuar këtë të fundit tek organet shtetërore për çdo pengesë që mund të haset në kuadër të pajisjes me leje, licenca, autorizime apo çdo lloj tjetër leje që nevojitet për ekzekutimin e punimeve dhe operimin e kësaj vepre. Ky parashikim nuk është i zbatueshëm kur mospajisja me leje, licensë, autorizim, etj, vjen si rezultat i mospërmbushjes së kërkesave ligjore përkatëse për shkak të Koncesionarit.
- 5.3. Të ndihmojë Koncesionarin në marrëdhënie dhe në lidhjen e marrëveshjeve/kontratave me institucione publike për qëllime të realizimit të objektit të kësaj kontrate.
- 5.4. Të garantojë Koncesionarin që ndërtimi i veprave të tjera hidroteknike nuk do të ndikojë në mbarëvajtjen e projektit të Koncesionarit.
- 5.5. Te miratojë Projektin e Zbatimit të Hidrocentralit, të përgatitur nga vete Koncesionari. Koha e nevojshme për miratimin e Projektit të Zbatimit nuk ben pjese ne grafikun e punimeve te parashikuar ne Aneksin 2, bashkëlidhur.
- 5.6. Te kontrollojë rregullisht ecurine e kontrates, sipas kushteve të përcaktuara në të.
- 5.7. Te garantojë blerjen e prodhimit të energjisë elektrike nga shoqëria KESH sh.a. për 15 vitet e para të prodhimit të energjisë elektrike.
- 5.8. Autoriteti Kontraktues është përgjegjës për detyrimet ligjore dhe kontraktore në rast të mospërmbushjes së këtyre detyrimeve nga ana e tij duke shpërblyer të gjitha dëmet e shkaktuara Koncesionarit për shkak të shkeljes së Kushteve të përcaktuara në kontratën e koncesionit.

Neni 6

Detyrimet dhe të Drejtat e Koncesionarit

Koncesionari është i detyruar të zbatojë Projektin dhe objektin e Kontrates konform termave dhe kushteve të saj.

Veçanërisht Koncesionari duhet që:

- 6.1. Brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga hyrja në fuqi e Kontrates së Koncesionit koncesionari të formojë shoqëri koncesionare, që do të ketë si objekt të veprimtarisë së saj projektimin, ndërtimin, operimin dhe transferimin e hidrocentralit tek Autoriteti Kontraktues. Shoqëria do t'i nënshtrohet të gjitha dispozitave ligjore, që rregullojnë veprimtarinë e shoqërive tregtare në Shqipëri, si dhe në rast transferimi të aksioneve apo pjesëve të kapitalit të saj tek të tretet, duhet të marrë pelqimin e autoritetit kontraktues.

Me krijimin e shoqërisë së re koncesionare, të gjitha të drejtat dhe detyrimet e lidhura me këtë kontratë do të transferohen nga Koncesionari tek Shoqëria Koncesionare duke filluar që nga data e regjistrimit të Shoqërisë Koncesionare në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

KONTRATE KONÇESIONI
E FORMES "ROT" (REHABILITIM - OPERIM - TRANSFERIM)
PER REHABILITIMIN E HIDROCENTRALIT "DOMAJ", HAS

Një kopje e aktit të themelimit, statutit dhe regjistrimit të shoqërisë së re si person juridik, do ti dorëzohet Autoritetit Kontraktues brenda 10 ditëve nga data e regjistrimit, për të marrë miratimin e këtij të fundit, duke patur parasysh që miratimi i këtij të fundit të jepet brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së dokumentit përkatës. Në rast vonese për shprehjen e miratimit, konsiderohet se Autoriteti Kontraktues nuk ka vërejtje apo sugjerime në lidhje me themelimin e personit të ri juridik. Në mënyrë të veçantë kërkohet që në përmbajtjen e Statutit të përfshihen të paktën:

- i. Forma e shoqërisë: Forma e shoqërisë do të jetë "shoqëri me përgjegjësi të kufizuar" ose "shoqëri aksionere", duke funksionuar në zbatim të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare";
- ii. Objekti i shoqërisë: Ndërtimi, operimi dhe transferimi i hidrocentralit "Domaj", tek Autoriteti Kontraktues, ku përfshihet financimi, projektimi, ndërtimi, vënia në punë, prodhimi, furnizimi, transmetimi, shpërndarja, eksportimi dhe shitja e energjisë elektrike, në zbatim të kësaj Kontrate Koncesioni. (Nuk lejohet asnjë lloj tjetër veprimtarie tregtare përveç atyre që ushtrohen në kuadër të kësaj Kontrate);
- iii. Kohëzgjatja: Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje me afatin e kësaj Kontrate Koncesioni;
- iv. Themeluesi i shoqërisë: Shoqëria e re do të themelohet vetem nga Koncesionari.

- 6.2. Te zbatoje punimet dhe planin e investimit sipas Aneksit nr.1 bashkelidhur kontrates.
- 6.3. Te respektoje te gjitha dispozitat ligjore shqiptare qe rregullojne veprimtarine e Shoqerise Koncesionare.
- 6.4. Te marre masa me qellim qe çdo investim te jete sipas afateve ne kete Kontrate dhe me cilesine e kerkuar;
- 6.5. Te administroje projektin per periudhen e koncesionit;
- 6.6. Te perballoje te gjitha shpenzimet qe lidhen me demet qe eventualisht mund t'i shkaktohen paleve te treta;
- 6.7. Te mbaje te informuar Autoritetin Kontraktues per çdo rrethane qe mund te kete ndikim ne ecurine e projektit;
- 6.8. Ne veprimtarine e tij te zbatoje legjislacionin shqiptar ne fuqi;
- 6.9. Te marra masa per te garantuar kushtet teknike per punetoret dhe te tretet, per te shmangur demet ndaj prones publike dhe private, te respektoje legjislacionin ne fuqi per te parandaluar çdo dem e fatkeqesi ne pune;
- 6.10. Koncesionari detyrohet te paguaje te gjitha shpenzimet per publikimet e bera, si dhe ato noteriale.
- 6.11. Te paraqese prane Autoritetit Kontraktues projektin e zbatimit brenda 6 (gjashte) muajve nga data e hyrjes ne fuqi te kesaj kontrate.
- 6.12. Te filloje punen brenda 30 ditesh nga data e marrjes se lejes se ndertimit.
- 6.13. Te zbatoje projektin per ndertimin e Hec-it "Domaj", me fuqi te vendosur prej 200 kW;

Neni 7 **Vleresimi i Investimeve**

Mbi bazen e te dhenave te Projektit, investimet qe duhet te kryhen nga koncensionari jane ne vleren totale prej 12,369,610 (dymbedhjetemilion e treqinde gjashtedhete e nente mije e gjashteqind e dhjete) leke, nga te cilat 5,000,000 (pesemilion) leke do te investohen ne makineri e pajisje.

Vleresimi i mesiperm mund te pesoje ndryshime te mundshme, me marreveshje ndermjet paleve:

- pas variantit perfundimtar te projektzbatimit
- ne çdo kohe gjate zbatimit te projektit ne ndertimin e vepres, sipas efektivitetit te ofertave

Vlera e ndryshuar e investimit mund te jete me e madhe se 12,369,610 (dymbedhjetemilion e treqinde gjashtedhete e nente mije e gjashteqind e dhjete) leke, por jo me e vogel se 11,749,780 (njembedhjetemilion e shtateqind e dyzet e nente mije e shtateqind e tetedhete) leke, qe perfaqeson nje ndryshim te investimit ne vleren 5% te investimit total te parashikuar.

Neni 8 **Programi i Punimeve**

Koncensionari merr persiper te zbatoje programin e meposhtem te punimeve :

- 8.1. Konçesionari merr persiper te ndertoj hidrocentralin brenda 12 (dymbedhjete) muajve nga data e marrjes se lejes se ndertimit, sipas Aneksit nr.2 bashkelidhur kesaj kontrate.
- 8.2. Koncesionari merr persiper te vere ne shfrytezim hidrocentralin brenda 24 (njezetekater) muajve nga hyrja ne huqi e kontrates se koncesionit.
- 8.3. Keto afate mund te ndryshohen me marreveshje midis Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit, ne se marrja e lejeve nga institucionet perkatese eshte vonuar pertej kohes se rregullt procedurale per marrjen e tyre.

Neni 9 **Zgjidhja e Kontrates se Konçesionit**

- 9.1. Autoriteti Kontraktues ka te drejten e prishjes se Kontrates se Konçesionit ne menyre te njeaneshme:
 - a) kur koncensionari nuk fillon punen brenda 6 muajve nga data e miratimit te projektit te zbatimit;
 - b) Ne rast te mosrealizimit te fuqise se vendosur mbi 10 % te asaj sipas projektit te propozuar nga koncesionari;
 - c) kur koncesionari kryen transferimin, ose shitjen e kuotave pa miratim te Autoritetit Kontraktues.
- 9.2. Kur nga ana e Autoritetit Kontraktues provohet, se gjate periudhes se konçesionit, ka shkelje te ndonje prej pikave te permendura ne kete kontrate, ai menjehere ia ben te njohura keto shkelje Koncesionarit, duke pritur per nje periudhe 30 ditore pergjigjen e tij, me argumentat perkates. Ne rast mbarimi te

ketij afati dhe koncensionari nuk sjell pergjigje, Autoriteti Kontraktues ka te drejte te zgjidhe kontraten.

- 9.3. Ne rastet kur Autoriteti Kontraktues zgjidh kontraten ne menyre te njeanshme (pika 1 e ketij neni), ai ka te drejte te marre vleren e garancise se kontrates. Autoriteti Kontraktues ka te drejte te marre persiper, perkohesisht administrimin e Hec-it, per sigurimin e nje sherbimi te efektshem dhe te panderprere dhe, ne rastin e deshtimit nga koncensionari, te permbushe detyrimet e tij kontraktuale dhe te deshtimit te tij, per te rregulluar shkeljen e kontrates.
- 9.4. Secila palë, ka të drejtë ta zgjidhë kontratën kur:
- a) përmbushja e detyrimeve bëhet e pamundur, për shkak të rrethanave që kanë qenë jashtë kontrollit të arsyeshëm të secilës palë;
 - b) ka shkelje serioze nga pala tjetër e kur kjo palë nuk mund ta korrigjojë këtë shkelje brenda afatit kohor dhe sipas mënyrës së parashikuar në kontratën e koncesionit.
- 9.5. Palët kanë të drejtë ta zgjidhin kontratën e koncesionit me pëlqim të dyanshëm.

Neni 10 Kontratat

Me qellim qe te realizohet objekti i koncesionit, Koncesionari ka te drejte te lidhe kontrata sipermarrjeje.

Ne te gjitha kontratat e sipermarrjes, ose nenkontraktoret, Koncesionari eshte i detyruar te respektoje kushtet e kesaj Kontrate.

Pavaresisht nga kontratat e mesiperme, pergjegjes para Autoritetit Kontraktues per zbatimin e rregullt te ketyre kontratave mbetet gjithmone Koncesionari.

Me perjashtim te te drejtave dhe detyrave qe i jepen Autoritetit Kontraktues ne kete kontrate, Autoriteti Kontraktues nuk do te marre persiper asnje detyrim kundrejt sipermarresve, furnizuesve dhe te treteve.

Koncesionari nuk ka te drejte ta jape kontraten e koncesionit me nenkoncesion.

Neni 11 Garancite

Koncesionari, para nenshkrimit te kontrates, duhet te ketë ngurtësuar në një institucion bankar ose shoqëri sigurimesh, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, per llogari te autoritetit kontraktues, para firmosjes se kontrates, nje shume te barabarte me 10% te vleres totale te investimit prej 1.236.961 (njemilion e dyqindetridhjete e gjashtemije e nenteqind e gjashtedhjete e nje)leke.

Koncesionari i lejohet te ç'ngurtesoje kete vlere vetem pasi te kete marre konfirmimin nga Autoriteti Kontraktues, brenda 30 diteve nga realizimi i investimit dhe kryerja e testimit te veqres.

Neni 12 Sigurimet

Konçesionari ne çdo kohe do te pajiset, mbaje dhe ripërterije ato garanci sigurimi te kerkuara ne lidhje me ushtrimin e te Drejtave Konçesionare dhe perdorimin e Objekteve Ekzistuese (ne se ka), dhe do t'i percjelle, ose do te kujdeset qe t'i percillen Autoritetit Kontraktues kopjet e çertifikuara te çdo çertifikate sigurimi pas marrjes se nje njoftimi te arsyeshem paraprak prej Autoritetit Kontraktues.

Konçesionari duhet të siguroje punimet e ndërtimit/montimit të objektit dhe më pas objektin e plotë gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës, të paktën nga rreziqet e parashikuara nga klasat e sigurimit 8 e 9 të nenit 7 të Ligjit 9267 dt.29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime" gjatë gjithë periudhës së Konçesionit dhe do të dorëzoje pranë Autoritetit Kontraktues një kopje të tij çdo vit, brenda një afati 15 ditor nga data e sigurimit.

Në rast të dëmtimeve në fazën e ndërtimit, apo gjatë operimit të objektit vlera e dëmit e kompensuar nga siguruesi sipas kontratave përkatëse të sigurimit duhet të perdoret për të rindërtuar, riparuar, risistemuar dhe për të rikthyer objektin në gjendjen që ishte para dëmtimit. Pjesa e zbritshme nga shuma qe siguruesi do te paguaje per kompesimin e demit do te perballohet nga konçesionari.

Konçesionari duhet të sigurojë përgjegjësinë e tij për dëmtimet që mund t'u shkaktohen palëve të treta për shkak të ushtrimit të veprimtarisë.

Sigurimi do te kryhet per kufij pergjegjesie jo me te ulet se 200 000 (dyqindmije) Euro per çdo ngjarje dhe 500 000 (peseqindmije) Euro ne vit. Pjesa e zbritshme nuk mund te jete me e larte se 1000 (njemije) Euro per çdo ngjarje dhe 2000 (dymije) Euro ne vit.

Autoriteti Kontraktues do te shenohet si i bashkesiguaruar ne te gjitha kontratat e sigurimit.

Neni 13 Kontrolli, Raportimi, Inspektimet dhe Mbikqyrja e Pergjithshme

Autoriteti Kontraktues ka te drejte te kontrolloje Konçesionarin gjate gjithe periudhes se konçesionit.

Konçesionari eshte i detyruar qe çdo muaj te raportoje me shkrim prane Autoritetit Kontraktues, realizimin e programit te investimeve ne vlere dhe ne natyre dhe me pas prodhimin e energjise elektrike.

Autoriteti Kontraktues ruan te drejten qe, gjate periudhes se konçesionit, nepermjet te autorizuarve te tij, te kontrolloje objektin per te vertetuar ne se rregullat e konçesionit po kryhen sipas kushteve te percaktuara ne kete kontrate.

Autoriteti Kontraktues mund te ushtroje nje mbikqyrje te pergjithshme gjate realizimit dhe venies ne pune, me synim qe te verifikojte se ecuria e punimeve, ashtu si cilesia dhe konformiteti, te jene ne perputhje me programin e pergjithshem te realizimit dhe çdokumentacionit te projektit.

Ne rast te shkeljeve te Kontrates, konstatuar gjate kontrollit te pergjithshem, Konçesionari do te njoftohet me shkrim per masat qe do te merren dhe detyrat qe do t'i lihen, si dhe menyren dhe afatet e zbatimit te tyre.

Neni 14

Tarifa koncesionare dhe vlera e riinvestimit

a. Tarifa koncesionare

Tarifa koncesionare eshte 2 % e energjise se prodhuar. Autoriteti Kontraktues ka te drejte ta shese kete sasi energjie per llogari te tij.

b. Vlera e riinvestimit

Vlera e riinvestimit eshte 60 % e vleres se investimit per makinerite dhe pajisjet. Kjo vlere do te investohet ne vitin 25 (njezete e peste) dhe do te aktualizohet sipas indeksit te inflacionit.

Neni 15

Legjislacioni i zbatueshem

Zbatimi dhe interpretimi i kesaj Kontrate Konçesioni do te bazohet ne legjislacionin shqiptar ne fuqi.

Neni 16

Forca Madhore

Konsiderohen ngjarje te Forces Madhore katastrofat e natyres, permbytjet, termetet, lufta dhe nderhyrja e paleve te treta qe kane fuqine e ligjit dhe çdo ngjarje e barabarte qe mund te ndikojne ne objektin e kesaj Kontrate, duke bere te pamundur permbushjen e detyrimeve reciproke te Marreveshjes, qe kane te bejne me vullnetin e paleve.

Gjate zbatimit te kontrates, ne rast se verifikohen vonesa te mundeshme ose mosrespektime te detyrimeve te Paleve, per shkak te ngjarjeve te Forces Madhore, ato nuk mund te jene shkak per kerkesa reciproke per zhdemtim.

Ne kete rast, kur nje detyrim i kesaj Kontrate do te prishet ose do te hiqet si rezultat i Forces Madhore, pala e demtuar eshte e detyruar te njoftoje me shkrim palen tjeter, brenda 15 diteve, duke i treguar dhe arsyetuar shtyrjen e punimeve ose braktisjen e tyre, si dhe masat qe do te merren per te parandaluar pasojat.

Kufijte e nderprerjes se punes dhe te shtyrjes ne kohe te punimeve, do te percaktohen nga palet ne nje procesverbal te ngjarjes.

Neni 17

Hyrja ne fuqi e Kontrates se Konçesionit

Kontrata e Konçesionit do te hyje ne fuqi mbasi te jete miratuar nga Keshilli i Ministrave te Republikes se Shqiperise, ne perputhje me Ligjin Nr.9663, date 18.12.2006 "Per konçensionet". (të ndryshuar).

Neni 18

Zgjidhja e Mosmarreveshjeve

Problemet ose mosmarreveshjet midis paleve, qe kane lidhje me zbatimin dhe interpretimin e kesaj Kontrate Konçesioni, nuk do te anullojne detyrimet e paleve sipas kesaj Kontrate.

Palet jane te angazhuara te zgjidhin çdo mosmarreveshje, duke u bazuar ne vullnetin e mire.

Ne te kundert, çdo mosmarreveshje qe lidhet me kete Kontrate Konçesioni, do te zgjidhet perfundimisht nga Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Tirane.

Neni 19

Sanksionet

Mos respektimi i afateve dhe kushteve te kesaj Kontrate, ne perfundim te periudhes 12 mujore, sipas Aneksit nr.2 bashkelidhur kesaj kontrate, penalizon konçesionarin si me poshte:

- 19.1. Per shkelje te afatit te ndertimit 0,05 % ne dite te vleres te investimeve te munguara.
- 19.2. Per moskryerje te investimeve ne vleren e marre persiper ne konkurim, konçesionari penalizohet me 10 % te vleres te investimeve te perealizuara.
- 19.3. Per cdo dite vonese per fillimin e punimeve penalizohet me 10 000 leke.
- 19.4. Ne rast mosrealizimi, per faj te konçesionarit, te prodhimit te energjise elektrike prej 1,000,000 KWh/vit, konçesionari penalizohet me 5% te vleres se prodhimit te perealizuar per periudhen raportuese.
- 19.5. Per mosrealizim deri ne 10% te fuqise se vendosur sipas projektit te propozuar nga konçesionari, ai do te penalizohet me 5% te vleres se prodhimit te energjise elektrike te munguar, si pasoje e zvogelimit te fuqise se instaluar.
- 19.6. Ne se mosrealizimi i fuqise se vendosur eshte me shume se 10 % te fuqise se vendosur sipas projektit te propozuar nga konçesionari, Autoriteti Kontraktues ka te drejte te prishe kontraten ne menyre te njeanshme.

Neni 20

Bashkepunimi midis Autoritetit Kontraktues dhe Konçesionarit

Autoriteti Kontraktues dhe Konçesionari jane zotuar te bashkepunojne ne menyre qe te garantojne realizimin e plote te projektit.

Perveç rasteve kur bien dakord me shkrim per ndonje forme tjeter, korrespondenca do te dergohet me leter me poste, telegram ose fax.

Per çdo ndihme qe do ti kerkohet Autoritetit Kontraktues nga koncesionari, ky i fundit detyrohet te paraqese kerkesen me shkrim per çka kerkon ne zbatim te detyrimeve te kesaj Kontrate.

Neni 21 Transferimi i Aseteve

Me mbarimin e Marreveshjes Koncesionare, qofte si perfundim i afatit te zakonshem ose si nje mbarim i parakohshem i saj, asetet e Koncesionit, perfshire çdo ndertese apo impiant te ndertuar nga Koncesionari ne kantjerin e Koncesionit, do t'i transferohet Autoritetit Kontraktues, pa shpërblim, apo detyrim shtese, subjekt i termave dhe kushteve te Marreveshjes Koncesionare. Autoriteti Kontraktues ka te drejten, por jo detyrimin, te nderhyje ne çdo kontrate te Koncesionarit.

Neni 22 Konfidencialiteti

Secila nga palët duhet të konsiderojë si konfidenciale të gjitha dokumentat dhe informacionet e tjera në lidhje me projektin, qofshin këto tregtare apo teknike, dhe nuk duhet t'ja bëjë të ditura një pale të tretë, të gjithë apo një pjesë të dokumentit apo informacionit, pa miratimin e palës tjetër, përveçse për qëllimin e përmbushjes së kushteve të kësaj kontrate.

Neni 23 Ndryshime

Kjo kontratë mund të pësojë ndryshim, shtesa dhe/ose zëvendësime vetëm me marrëveshje me shkrim të dy palëve.

Çdo ndryshim i kësaj kontrate apo anekseve bashkëlidhur saj, pasi të hyjë në fuqi, do të jetë pjesë përbërëse dhe e pandashme e kësaj kontrate.

Neni 24 Bashkëpunimi midis Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit

Autoriteti Kontraktues dhe Koncesionari janë zotuar të bashkëpunojnë në mënyrë që të garantojnë realizimin e plotë të projektit.

Çdo komunikim për çdo problem ndërmjet palëve, do të bëhet vetëm me shkrim, në adresat e treguara më poshtë nga palët. Palët janë të detyruara t'i njoftojnë menjëherë njëra-tjetrës çdo ndryshim të secilës prej këtyre të dhënave, brenda një afati 10 (dhjetë) ditor nga data e ndryshimit.

Për çdo ndihmë që do t'i kërkohej Autoritetit Kontraktues nga koncesionari, ky i fundit detyrohet të paraqesë kërkesën me shkrim për çka kerkon në zbatim të detyrimeve të kësaj Kontrate.

Adresat dhe numrat e kontaktit që do të perdoren gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshje janë:

Për Autoritetin Kontraktues

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë
dhe Energjetikës
Blvd. Zogu i Për, Nr. 1001,
Tiranë - Shqipëri

Për Koncesionarin

Shoqëria "Thaci" sh.p.k.
Adresa: Komuna Gjinaj, Fshat Domaj
Kukes - Shqiperi
Tel: +355692345682

Neni 25
Rregjistrimi i Kontratës

Brenda 30 ditëve nga miratimi i projektit të zbatimit, kjo Kontratë duhet të rregjistrohet në regjistrin e pasurive të paluajtshme.

Kjo kontratë u hartua në 3 (tri) kopje, në gjuhën shqipe, dhe pasi ju lexua palëve, të cilët e kuptuan dhe e pranuan atë, e nënshkruan me vullnet të lirë e të plotë, dhe unë noterja e vërtetoj atë rregullisht sipas ligjit.

PALËT

AUTORITETI KONTRAKTUES

**Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe
Energjetikes**

Perfaqesuar nga


KONCESIONARI

**Bashkimi i Shoqerive
"Thaci" Shpk dhe "Lala" Shpk**

Perfaqesuar nga

Z. Genc RULI

Z. Shkelqim THACI



Iskender Meto
Iskender Meto

Shkelqim Thaci
THACI *
SH.P.K.
IMPORT-EXPORT
KUKES-ALBANIA